



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
KËSHILLI DREJTUES

V E N D I M

Nr. 7 , datë 06.09.2023

PËR

“MIRATIMIN E DOKUMENTIT:
“PLANI I PËRDORIMIT TË FREKUENCAVE””

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), me pjesëmarrjen e:

Z.	Tomi	Frashëri	Kryetar
Znj.	Edlira	Dvorani	Anëtar
Znj.	Ketrin	Topçiu	Anëtar
Z.	Lorenc	Bako	Anëtar

dhe sekretare Znj. Evblina Taçi, në mbledhjen e datës 06.09.2023 sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe Rregullore e Brendshme për “Funksionimin e Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare” miratuar me Vendimin Nr.7, datë 16.02.2017 të Këshillit Drejtues të AKEP, me propozim të Drejtorisë Teknike, shqyrtoi çështjen me objekt:

- *Për miratimin e dokumentit: “Plani i Përdorimit të Frekuencave”.*

BAZA LIGJORE:

1. Shkronja ë) e nenit 8, pika 2 e nenit 62, neni 64 dhe neni 110 i ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008, “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (***ligji nr. 9918***);
2. Plani Kombëtar i Frekuencave, miratuar me VKM Nr. 1187, datë 24.12.2020 “Për miratimin e Planit Kombëtar të Frekuencave” (***PKF***);

3. Plani i Përdorimit të Frekuencave, miratuar me VKD Nr. 06, datë 31.03.2022 “ Për miratimin e Planit të Përdorimit të Frekuencave” (*PPF*);
4. Rregullore për Procedurat e Këshillimit Publik, miratuar me vendimin nr.21, datë 07/12/2021;
5. Shkronja i), pika 1.2 e nenit 19 të Rregullores së Brendshme për “Funksionimin e Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare”, miratuar me Vendimin Nr.7, datë 16.02.2017 të Këshillit Drejtues të AKEP.

K Ë S H I L L I D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor,

- Dokumenti: “*Plani i Përdorimit të Frekuencave*”;
- Relacioni shoqërues i projekt aktit miratues (Relacioni);
- Projekt-akti miratues i dokumentit (projektvendimi).

si dhe nga diskutimet në mbledhje mbi çështjen, dhe duke iu referuar bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N:

1. Plani i Përdorimit të Frekuencave i miratuar me VKD Nr. 06, datë 31.03.2022 “Për miratimin e Planit të Përdorimit të Frekuencave” (*PPF*), përfshin:
 - a) brezat e frekuencave të përcaktuara në Planin Kombëtar të Frekuencave (PKF) të miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1187, datë 24.12.2020 “Për miratimin e Planit Kombëtar të frekuencave” (PKF), për përdorime “civile”, të cilat mund të përdoren për qëllime civile, si dhe zbatimet e shërbimeve radio të përcaktuara në këto breza frekuencash;
 - b) rregullat lidhur me përdorimin e brezave të frekuencave, përfshi karakteristika të administrimit të frekuencave për rrjete të radiokomunikimeve dhe radio stacionet dhe të pajisjeve radio, metodën e dhënies së frekuencave, raste të ndryshëm nga autorizimi individual i përdorimit të frekuencave, kërkesat teknike dhe kushtet e operimit lidhur me operimin e radio sistemeve;
 - c) implementimin e ndryshimeve të rëndësishme që kanë pësuar brezat për aplikimet GSM, IMT, BWA, etj. si përse i përket teknologjive të aplikuara në këto breza ashtu edhe shërbimeve të ofruara.
 - d) detaje dhe mënyrën e ndarjes së kanaleve, kanalet e mundshme për caktim, parametrat teknikë që duhet të zbatohen etj.
2. Në përputhje me përcaktimet e ligjit 9918/2008 dhe Rregulloren e AKEP për “Procedurat e Njoftimit dhe Këshillimit Publik” miratuar me VKD nr. 21 datë 7.12.2021, Këshilli Drejtues i AKEP me Vendin Nr.6, datë 19.07.2023 miratoi për këshillim publik

dokumentin: “Plani i Përdorimit të Frekuencave”. Afati për kryerjen e këshillimit Publik ishte 30 ditë pune nga data e njoftimit të dokumentit në faqen zyrtare të AKEP, www.akep.al.

3. Pas përfundimit të periudhës së këshillimit publik me palët e interesuara, AKEP ka hartuar dokumentin përfundimtar “Plani i Përdorimit të Frekuencave”, i cili sintetizon ndryshimet e referuara në dokumentin për këshillim publik.
4. Në zbatim të Planit Kombëtar të Integritimit Europian (PKIE) 2023-2025 për Kapitullin 10, Shoqëria e Informacionit dhe Media, janë transpozuar në dokumentin e Planit të Përdorimit të Frekuencave 7 acquis që lidhen me spektrin e frekuencave.
5. Ky dokument nga pikëpamja e ligjshmërisë është në konformitet me përcaktimet ligjore të parashikuara në ligjin Nr. 9918, datë 19.05.2008, “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Në mbështetje të nenit 114 dhe nenin 115, të ligjit nr. 9918, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Këshilli Drejtues i AKEP;

V E N D O S I:

1. Të miratojë dokumentin “Plani i përdorimit të frekuencave”, sipas dokumentit bashkëlidhur.
2. Ky vendim dhe dokumenti “Plani i përdorimit të frekuencave” publikohen në faqen zyrtare të AKEP, www.akep.al;
3. Ngarkohet Drejtoria Teknike për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetar	Anëtar	Anëtar	Anëtar
Tomi Frashëri	Edlira Dvorani	Ketrin Topçiu	Lorenc Bako